

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHETËRORE**

PËR ARSIMIN E MESËM

NË LËNDËN:

GJEOGRAFI

VITI MËSIMOR 2008-2009

Tiranë, 2009

Udhëzime për zbatimin e programit

Programi orientues për lëndën me zgjedhje gjeografi, përfshin njohuritë dhe konceptet më të rëndësishme të gjeografisë për shkollën e mesme. Ndjekja e këtij programi nga shkollat dhe nxënësit siguron një formim të mirë gjeografik të nxënësve, si bazë për studimet e mëtejshme universitare të tyre.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të gjeografisë, në kuadrin e maturës shtetërore për vitin shkollor 2007-2008, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme të përgjithshme, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e maturës shtetërore.

- ◆ Programi gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e gjeografisë së shkollave të mesme të përgjithshme që do të përgatisin maturantët për provimin e gjeografisë si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- ◆ Programi gjithashtu orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e gjeografisë.
- ◆ Programi përbën gjithashtu një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të gjeografisë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të të interesuarve, sidomos kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të gjeografisë si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provimin e gjeografisë, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Konceptet kryesore dhe objektivat që lidhen me përvetësimin e tyre

<p>1. Gjeografia 1 (fizike e përgjithshme)</p> <p><i>Nxënësit duhet të jenë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Të shpjegojnë se sipërfaqja e Tokës përbëhet nga disa pjesë: atmosfera, litosfera, hidrosfera, biosfera, të cilat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, ku çdo ndryshim i secilës prej tyre reflektohet në formën e një reaksioni zinxhir tek të tjerat; -të identifikojnë dhe analizojnë veçoritë natyrore dhe burimet natyrore të vendeve dhe të rajoneve të botës; -të shpjegojnë veçoritë kryesore të pozitës gjeografike, relievit, klimës, hidrografisë, tokave, bimësisë dhe botës shtazore në tërësi por dhe të rajoneve gjeografike në veçanti. 	<p>Të kuptuarit e koncepteve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajnë ndërtimin, veçoritë fizike dhe strukturën e përgjithshme të rruzullit tokësor; - të përcaktojnë pozicionin e Tokës në sistemin diellor dhe të tregojnë efektet e këtij pozicioni; - të përshkruajnë mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe rreth Diellit, duke treguar pasojat e tyre në gjeosistem; - të analizojnë shkaqet e formimit të vullkaneve dhe të tërmeteve dhe lidhjen e veprimit të tyre me veprimtarinë jetësore të njeriut; - të përshkruajnë burimet e energjisë në Tokë dhe të shpjegojnë rëndësinë e energjisë diellore për Tokën, duke treguar llojet e rrezatimit, bilancin dhe vlerat e rrezatimit; - të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në formimin e tokave dhe të përshkruajnë llojet e tyre. - të shpjegojnë se si tiparet dhe shpërndarja e bimësisë dhe e kafshëve janë rezultante e ndërveprimit të të gjithë faktorëve përbërës të gjeosferës dhe të energjisë diellore; - të përshkruajnë dhe të krahasojnë mjediset e ndryshme jetësore të botës, duke shpjeguar faktorët që ndikojnë në zhvillimin e bimësisë dhe të kafshëve si dhe ndikimin e njeriut në to; - të shpjegojnë konceptin klimë dhe të analizojnë faktorët e formimit të saj (gjerësia gjeografike, relievi, qarkullimi i atmosferës, rrymat oqeanike, lartësia mbi nivelin e detit, njeriu); - të analizojnë elementet kryesore të lumenjve si dhe të shpjegojnë konceptet sistem lumor, pellg ujëmbledhës, vijë ujëndarëse; - të demonstrojnë kuptimin për detet dhe oqeanet, shpërndarjen gjeografike, veçoritë, rëndësinë si dhe lëvizjet e ujërave të tyre (baticë-zbaticë);
<p>2. Gjeografia 2 (rajonale)</p> <p><i>Nxënësit duhet të jenë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Të analizojnë pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të rajoneve dhe 	<p>Të kuptuarit e koncepteve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojnë dhe të shpjegojnë shpërndarjen globale të njerëzimit, duke vënë theksin tek përqëndrimet e popullsisë, të cilat udhëheqin këtë proces; - të përcaktojnë dhe të analizojnë pozitën

<p>vendeve të ndryshme të botës;</p> <p>-të identifikojnë dhe të interpretojnë tiparet dhe veçoritë dalluese të popullsisë, ekonomisë dhe të hartës politike të vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës;</p> <p>-të përshkruajnë veçoritë e shpërndarjes dhe të lëvizjes hapësinore të popullsisë, të mallrave dhe të ideve në botën e sotme.</p>	<p>gjeografike dhe kushtet natyrore të kontinenteve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojnë dhe analizojnë treguesit dhe natyrën e popullsisë në kontinentet Evropë dhe Azi; - të identifikojnë veçoritë e zhvillimit ekonomik të vendeve dhe rajoneve në botë. - të përcaktojnë dhe analizojnë pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të gadishullit të Ballkanit; - të përcaktojnë dhe analizojnë pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të shteteve evropiane, aziatike, amerikane dhe të Australisë; - të identifikojnë dhe analizojnë karakteristikat e zhvillimit të popullsisë të vendeve evropiane, aziatike, amerikane dhe të Australisë; - të analizojnë zhvillimin e degëve të ekonomisë të shteteve evropiane, aziatike, amerikane dhe të Australisë; - të krahasojnë dukuritë themelore që shfaqen në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim; - të analizojnë rolin që luajnë vende të ndryshme në kuadrin e ekonomisë globale dhe rolin e kësaj të fundit në zhvillimin ekonomik të çdo vendi.
<p>3. Gjeografia 3 (trashëgimia natyrore dhe kulturore ndërkombëtare dhe kombëtare)</p> <p><i>Nxënësit duhet të jenë në gjendje:</i></p> <p>-Të identifikojnë dhe vlerësojnë ndërveprimin e veprimtarive njerëzore dhe ndikimin e tyre në mjedisin natyror;</p> <p>-të përshkruajnë rëndësinë e resurseve natyrore dhe të mbrojtjes së mjedisit gjeografik duke evidentuar disa nga lidhjet shkak-pasojë;</p> <p>-të vlerësojnë lidhjet ndërmjet dukurive fiziko-gjeografike dhe trashëgimisë natyrore;</p>	<p>Të kuptuarit e koncepteve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrojnë të kuptuarit e mënyrave të ndryshme të ndikimit të shoqërisë njerëzore në cilësitë e mjediseve gjeografike dhe të shfrytëzimit të resurseve; - të përshkruajnë, duke dhënë shembuj konkretë, të dëmtimeve që ka pësuar mjedisi gjeografik nga veprimtaria njerëzore; - të analizojnë shkaqet dhe shenjat dalluese të krizës mjedisore në këto 20 vitet e fundit të lidhura kryesisht me veprimet dhe qëndrimet e njeriut; - të demonstrojnë kuptimin e konceptit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, kombëtare dhe ndërkombëtare; -të komentojnë <i>Konventën Ndërkombëtare të Trashëgimisë Botërore</i>; -të interpretojnë Listën e Trashëgimisë Botërore, me kriteret dhe rregullat e anëtarësimit të objekteve dhe siteve të vendit në këtë listë; - të përshkruajnë kriteret e kategorizimit të zonave të mbrojtura sipas IUCN;

<p>-të shpjegojnë lidhjet ndërmjet zhvillimeve sociale, historike dhe ekonomike të shoqërisë dhe trashëgimisë kulturore të saj</p>	<p>-të listojnë kriteret e përzgjedhjes së rezervateve strikte natyrore; -të vlerësojnë rëndësinë e monumenteve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore.</p>
<p>4. Gjeografia 4 (Republika e Shqipërisë dhe trevat shqiptare)</p> <p><i>Nxënësit duhet të jenë në gjendje:</i></p> <p>-Të përshkruajnë dhe vlerësojnë përbërjen dhe pozitën gjeografike të trevave shqiptare;</p> <p>-të identifikojnë dhe interpretojnë karakteristikat e përgjithshme të natyrës të trevave shqiptare;</p> <p>-të analizojnë natyrën e popullsisë dhe të vendbanimeve të trevave shqiptare;</p> <p>-të përcaktojnë dhe analizojnë zhvillimet ekonomike të trevave shqiptare.</p>	<p>Të kuptuarit e koncepteve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojnë në hartën e gadishullit të Ballkanit shtrirjen gjeografike të trevave shqiptare; - të analizojnë pozitën e volitshme gjeografike të trevave shqiptare në rajon, Evropë dhe në botë; - të demonstrojnë format e relievit në varësi të faktorëve të formimit të tyre; - të listojnë faktorët e formimit të klimës dhe zonat klimatike të trevave shqiptare; - të identifikojnë dhe të vlerësojnë shumëllojshmërinë e pasurisë ujore të trevave shqiptare; - të nxjerrin në pah lidhjen e ndërsjelltë midis relievit dhe shpërndarjes gjeografike të tokave, bimësisë, dhe botës shtazore; - të argumentojnë vazhdimësinë e popullsisë dhe të vendbanimeve në lidhjen iliro-arbëro-shqiptare; - të demonstrojnë konceptin migrim dhe të analizojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të migrameve gjatë etapave historike; - të demonstrojnë ndikimin e mjedisit natyror dhe kushteve historiko-shoqërore në zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare; - të analizojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe problematikat e tyre në kushtet e reja të ekonomisë së tregut; - të demonstrojnë dhe analizojnë vlerat ekologjike të mjedisit, ekosistemet si dhe problemet e ndotjes në trevat shqiptare; - të demonstrojnë dhe analizojnë pozitën gjeografike, kushtet natyrore, popullsinë, vendbanimet dhe degët e ekonomisë të rajoneve të trevave shqiptare.

**Përmbajtja e listuar sipas teksteve mësimore të
gjeografisë**

Gjeografia 1

Kapitulli	Temat mësimore
Toka	<ol style="list-style-type: none"> 1. Toka ku ne jetojmë 2. Qarkullimi i Tokës rreth Diellit 3. Paraqitja e sipërfaqjes së Tokës në hartë 4. Ndërtimi dhe veçoritë fizike të Tokës 5. Struktura e përgjithshme e rruzullit tokësor 6. Lëvizjet malformuese 7. Lëvizjet luhatëse 8. Tërmetet 9. Vullkanet
Atmosfera	<ol style="list-style-type: none"> 1. Atmosfera 2. Energjia në gjeosistem 3. Temperatura e ajrit 4. Trysnia atmosferike dhe masat ajrore 5. Erërat 6. Tipat e erërave 7. Ciklonet dhe anti-ciklonet 8. Klima
Hidrosfera	<ol style="list-style-type: none"> 1. Veçoritë e përgjithshme të hidrosferës 2. Baticat dhe zbaticat (maretë) 3. Veprimi gjeodinamik i detit 4. Lumenjtë dhe problemi i ujit 5. Liqenet
Tokat dhe Biogjeografia	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tokat (Dherat) 2. Bota bimore 3. Bota shtazore (Fauna)
Mjediset jetësore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zona me klimë të butë 2. Problemet e mjedisit 3. Ligjet e përgjithshme të gjeosistemit

Gjeografia 1 (Tiranë 2006); Autorë: Prof.Dr. V. Trojani; Prof.Dr. V. Kristo

Gjeografia 2

Kapitulli	Temat mësimore
Probleme të përgjithshme të mjedisit gjeografik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bota rreth nesh 2. Gjeografia e kulturave
Evropa	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pozita gjeografike e Evropës 2. Drejtimet gjeopolitike pas Luftës II Botërore 3. Gjeografia e problemeve rajonale dhe të përgjithshme 4. Pozita gjeografike e Rosisë dhe e Evropës Lindore 5. Fuqizimi i shteteve në Evropën Lindore
Amerika e Veriut dhe Amerika Latine	<ol style="list-style-type: none"> 1. Format e Tokës, lumenjtë 2. Klima dhe bimësia 3. Modelet e popullsisë 4. Jeta në SHBA dhe Kanada në ditët e sotme 5. Forma e tokës, lumenjtë, klima dhe burimet natyrore 6. Zhvillimi politik dhe ekonomik 7. Problemet rajonale dhe globale
Afrika, Lindja e Mesme, Azia Jugore, Azia Juglindore, Azia Lindore, Australia dhe Oqeania	<ol style="list-style-type: none"> 1. Veçoritë e kushteve natyrore (Afrika) 2. Toka dhe popujt 3. Tri vende në rrugën drejt modernizimit 4. Problemet rajonale dhe globale (Lindja e Mesme) 5. Veçoritë natyrore (Azia Jugore) 6. Problemet rajonale dhe globale (Azia Jugore) 7. Format e Tokës (Azia Juglindore) 8. Gjeografia e Azisë Juglindore në botën e sotme 9. Gjeografia e Australisë dhe Oqeanisë 10. Natyra dhe popullsia e Kinës 11. Republika Popullore e Kinës, zhvillimi ekonomik 12. Japonia një botë e veçuar 13. Rritja ekonomike – mrekullia japoneze

Gjeografia 2 (Tiranë 2001); Autorë: Eqerem Yzeiri, Agron Nishku, Bilal Draçi, Bedri Kola.

Gjeografia 2 (Tiranë 2006); Autorë: Eqerem Yzeiri, Agron Nishku, Bilal Draçi, Bedri Kola.

Gjeografia 3

Kapitulli	Temat mësimore
Mjedisi në vështrimin gjeografik	<ol style="list-style-type: none">1. Mjedisi, funksionimi i tij, shkaktarët e problemeve mjedisore dhe burimet e energjisë2. Problemet mjedisore globale dhe masat ligjore e administrative për menaxhimin e tyre
Pasuritë e veçanta natyrore dhe kulturore ose trashëgimia	<ol style="list-style-type: none">1. Koncepti i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, kombëtare dhe ndërkombëtare
Trashëgimia natyrore kombëtare	<ol style="list-style-type: none">1. Kategorizimi i zonave të mbrojtura sipas IUCN2. Rezervate strikte natyrore3. Monumentet e natyrës në Shqipëri
Monumentet e kulturës dhe rëndësia e trashëgimisë kulturore	<ol style="list-style-type: none">1. Monumentet e kulturës dhe rëndësia e trashëgimisë kulturore

Gjeografia 3 (Tiranë 2006); Autorë: Merita Dollma.

Gjeografia 4

Kapitulli	Temat mësimore
Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përbërja dhe pozita gjeografike e trevave shqiptare 2. Harta politike e trevave shqiptare
Natyrë e trevave shqiptare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi gjeologjik 2. Ndërtimi gjeologjik (vazhdim) 3. Faktorët e formimit të relievit 4. Sistemet kryesore malore, kodrinore dhe fushore, ndikimi i tyre në veçoritë e tjera natyrore dhe në zhvillimin ekonomik 5. Tipare të përgjithshme të klimës 6. Zonat klimatike dhe veçoritë e tyre 7. Pasuri të mëdha dhe të larmishme ujore 8. Lumenjtë kryesorë 9. Llojet e tokave dhe veçoritë e tyre 10. Bota bimore dhe shtazore
Organizimi administrativ i trevave shqiptare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimi administrativ i trevave shqiptare
Popullsia dhe vendbanimet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Popullsia dhe vendbanimet 2. Migrimet e popullsisë shqiptare 3. Vendbanimet në trevat shqiptare
Ekonomia	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mjedisi natyror dhe kushtet historiko-shoqërore për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare 2. Sektori i parë i ekonomisë 3. Sektori i dytë i ekonomisë 4. Sektori i tretë i ekonomisë
Rajonet gjeografike të trevave shqiptare	<ol style="list-style-type: none"> 1. Republika e Shqipërisë. Veçori të përgjithshme gjeografike 2. Popullsia 3. Ekonomia dhe rajonet gjeografike 4. Rajoni Verior dhe Verilindor 5. Popullimi dhe ekonomia e Alpeve Shqiptare 6. Nënrajonit verilindor 7. Pjesët përbërëse të nënrajonit verilindor (vazhdim): Lugina e Drinit të Zi dhe Drinit si dhe Vargu i Korabit 8. Pjesët përbërëse të nënrajonit verilindor (vazhdim): Malësitë e Martaneshit, Cermenikës dhe Gollobordës 9. Rajoni Juglindor: Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore

	<ul style="list-style-type: none"> 10. Popullimi i Rajonit Juglindor 11. Ekonomia e Rajonit Juglindor 12. Rajoni Jugor: Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore 13. Popullimi i rajonit jugor 14. Ekonomia e rajonit jugor 15. Rajoni perëndimor: Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore 16. Popullimi i rajonit perëndimor 17. Ekonomia në rajonin perëndimor të Shqipërisë 18. Sektori i tretë i ekonomisë në rajonin perëndimor
Trevat e tjera shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> 1. Kosova: Pozita gjeografike, kufijtë, madhësia 2. Kushtet natyrore (vazhdim) 3. Popullsia 4. Ekonomia e Kosovës 5. Rajoni lindor i Kosovës 6. Rajoni perëndimor
Trevat e tjera shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> 1. Trevat shqiptare në Serbi
Trevat e tjera shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> 1. Trevat shqiptare në Maqedoninë Perëndimore
Trevat e tjera shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> 1. Trevat shqiptare në Mal të Zi
Trevat e tjera shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> 1. Trevat shqiptare në Greqi

Gjeografia 4 (Tiranë 2007); Autorë: Perikli Qiriaz, Dhimitër Doka, Asllan Pushka

GJEOGRAFIA

SHPERNDARJA E PESHAVE SIPAS LINJAVE

1.	Gjeografia 1 (fizike e përgjithshme)	28 orë	26%
2.	Gjeografia 2 (rajonale)	27 orë	25%
3.	Gjeografia 3 (trashëgimia natyrore dhe kulturore)	7 orë	5%
4.	Gjeografia 4 (Republika e Shqipërisë dhe trevat shqiptare)	48 orë	44%
	<i>Gjithsej</i>	<i>110 orë</i>	<i>100%</i>

SHPERNDARJA E PESHAVE SIPAS FUSHAVE

Gjeografia 1 (Fizike e përgjithshme)

1.	Toka	9 orë	32%
2.	Atmosfera	8 orë	28%
3.	Hidrosfera	5 orë	18%
4.	Tokat dhe biogjeografia	3 orë	11%
5.	Mjediset jetësore	3 orë	11%
	<i>Gjithsej</i>	<i>28 orë</i>	<i>100%</i>

Gjeografia 2 (Rajonale)

1.	Probleme të përgjithshme të mjedisit	2 orë	7%
2.	Evropa	5 orë	19%
3.	Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut	7 orë	26%
4.	Afrika, Lindja e Mesme, Azia Jugore, Azia Juglindore, Azia Lindore, Australia dhe Oqeania	13 orë	48%
	<i>Gjithsej</i>	<i>27 orë</i>	<i>100%</i>

Gjeografia 3 (Trashëgimia natyrore dhe kulturore)

1.	Mjedisi në vështrimin gjeografik	2 orë	29%
2.	Pasuritë e veçanta natyrore dhe kulturore	1 orë	14%
3.	Trashëgimia natyrore kombëtare	3 orë	43%
4.	Monumentet kulturore	1 orë	14%
	<i>Gjithsej</i>	<i>7 orë</i>	<i>100%</i>

Gjeografia 4 (Republika e Shqipërisë dhe trevat Shqiptare)

1.	Përbërja dhe pozita gjeografike e trevave shqiptare	2 orë	4%
2.	Natyra e trevave shqiptare	10 orë	21%
3.	Organizimi shtetëror dhe administrativ	1 orë	2%
4.	Popullsia dhe vendbanimet	3orë	6%
5.	Ekonomia	4 orë	8%
6.	Rajonet gjeografike të trevave shqiptare (Republika e Shqipërisë)	18 orë	38%
7.	Kosova	6 orë	13%
8.	Trevat Shqiptare në Serbi	1 orë	2%
9.	Trevat Shqiptare në Maqedoninë Perëndimore	1 orë	2%
10.	Trevat Shqiptare në Mal të Zi	1 orë	2%
11.	Trevat shqiptare në Greqi	1 orë	2%
	<i>Gjithsej</i>	<i>48 orë</i>	<i>100%</i>